



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE LEGJISLACIONIT

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**SPECIALIST I RRJETIT ELEKTRIK, SPECIALIST URBANIST DHE LEJEVE DHE
SPECIALIST I ZBATIMIT DHE MONITORIMIT TË INVESTIMEVE NË DREJTORINË
E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE**

**SPECIALIST PROJEKTUES NË DREJTORINË E PROJEKTEVE DHE
EMERGJENCAVE CIVILE**

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Keshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin në kategorinë ekzekutive”, Bashkia Patos shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe e pranimin në shërbimin civil për pozicionet:

një vend pune si Specialist i Rrjetit Elektrik dhe një vend pune Specialist Urbanist dhe Lejeve, një vend pune Specialist i Zbatimit dhe Monitorimit të Investimeve në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve, kategoria e pagës IV-4, si dhe dy vende pune Specialist Projektues në Drejtorinë e Projekteve dhe Emergjencave Civile, kategoria e pagës IV-3.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në Shërbimin Civil

Për procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

30/06/2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

07/07/2025

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist i Rrjetit Elektrik:**

1. Bashkëpunon me ndërmarrje të tjera homologe si ujësjellës-kanalizime, OSSH dhe Telekom, për mirëmbajtjen e rrjetit të infrastrukturës nëntokësore, për të evituar ndërhyrjet e pavullnetshme në dëm të infrastrukturës rrugore.
2. Merr masa dhe preventivon nevojat materiale, për riparimet në të gjitha akset rrugore, mbështetur në fondet e akorduara për këtë qëllim.
3. Realizon inventarizimin e rrjetit rrugor, të gjendjes fizike të tij, të sinjalistikës horizontale e vertikale dhe parashikon ndërhyrjet, për rehabilitimin e tyre çdo gjashtë mujor.
4. Ndjek problemet në fushën e ndriçimit publik, duke bërë kontroll vizual të herë pas herëshëm të rrugëve, lulishteve dhe fasadave të institucioneve kryesore të qytetit, përgatit raporte dhe evidenca për ndërhyrje si për zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit të ndriçimit. Merr masa për mirëfunksionimin e tij gjatë gjithë vitit. Komunikon për zgjidhjen e këtyre problemeve me Ndërmarrjen e Rregullim-Territorit.
5. Ndjek problemet e rrjetit elektrik egzistues të ndriçimit të rrugëve, objekteve arsimore etj, dhe rakordon me elektrikistët e Ndërmarrjes Urbane dhe Rurale, korigjon në kohë defektet.
6. Ndjek me studime konkrete problemet e zgjerimit të rrjetit elektrik në të tre njësitë administrative, harton projektet e zbatimit sipas fondeve të vëna në dispozicion për këtë qëllim (projekt – preventive elektrik të ndriçimit të rrugave, shkollave, kopshteve, çerdheve, lulishteve etj).
7. Ndjek marrdhëniet me institucionet e OSHEE, për problemet e lidhjeve të reja, harton dokumentacionin tekniko ligjor dhe i paraqet për miratim.
8. Kontrollon pajisjet në institucionet e Bashkisë, si kaldajat, sobat elektrike, dushe, kontator, limitator etj, dhe merr masa për mirëfunksionimin e tyre.
9. Harton data-base, regjistron objektet e lidhura me energji, kontrollon faturimet, rakordon me specialistët e OSHEE.
10. Propozon masa për kursimin e energjisë elektrike duke ndërhyrë me projekte konkrete në zëvendësimin e ndricuesve, të kablllove etj, me qëllim përmirësimin e rrjetit egzistues.
11. Një herë në muaj bën informacion mbi gjendjen e rrjetit elektrik, problemet që kanë dalë dhe mënyrën e zgjidhjes së problemit.
12. Merr masa për sigurimin teknik nga energjia për çdo objekt, rrugë dhe propozon masa konkrete dhe të shpejta për zgjidhje. Me miratimin e Drejtorisë ndërpret furnizimin e energji në çdo rast që vërehen parregullsi në rrjet.
13. Ndjek hartimin e projekt buxhetit për vitin pasardhës për kompletimin e rrjetit elektrik, pajisjeve etj, për objektet e mirëmbajtjes së rrjetit të ndriçimit dhe objekteve arsimore etj, harton projekt preventivat për mirëmbajtjen e këtyre objekteve
14. Bashkërendon punën me ndërmarrjen e vartësisë që mbulon fushën e sinjalistikës në drejtim të vlerësimit të detyrave të dhëna dhe të mirëmbajtjes së sinjalistikës në përgjithësi.

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist Urbanist dhe Lejeve:**

1. Bën planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.
2. Bën përllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe njoftimet e qytetarëve për pagesën e taksës.
3. Merr në konsideratë çdo aplikim në sistemin e-leje si dhe kthim përgjigjet për çdo aplikim.
4. Siguron dhe merr në konsideratë kthim përgjigje për shkresat e adresuara drejtorisë brenda afateve.
5. Ndjek detyrat e ngarkuara nga eprori dhe raporton për çdo problem që del gjatë punës

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist i Zbatimit dhe Monitorimit të Investimeve:**

1. Zbaton me përpikmëri dhe me nivel të lartë profesional detyrat e ngarkuara mbi bazën e planeve vjetore e publike të miratuara.
2. Në bashkëpunim me përgjegjësën realizon funksionimin e Sektorit të Shërbimeve, i cili ka për detyrë mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, si rrugë, trotuare, kanalizime, institucionet e arsimit, të kulturës, çerdhen e qytetit, zyrat e administratës dhe të gjitha objektet prone e Bashkisë.
3. Evidenton gjendjen e infrastrukturës dhe përgatit një raport të cilin ia prezanton drejtorit të drejtorisë.
4. Të ndjek dhe kontrollojë zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për probleme që kanë lidhje me sektorin ose me ndërmarrje që monitorohen prej saj.
5. Të kontrollojë investimet publike sipas grafikut të miratuar nga drejtori i drejtorisë.
6. Të përgatisi një informacion periodik mbi monitorimet e investimeve publike dhe t'ja paraqesi atë përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë.
7. Menaxhon e monitoron investimet publike.

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist Projektues:**

1. Studion dhe iu jep zgjidhje problemeve të infrastrukturës së qytetit ku përfshihen: rrugë, trotuare, rrjeti i kanalizimeve, etj.
2. Siguron bashkëpunim me përfaqësues të biznesit, forumet dhe përfaqësuesit komunitare lokale për identifikimin e partnerëve lokal pjesëmarrës në zbatimin e projekteve.
3. Projekton dhe bën preventiva të rikonstruksioneve dhe ndërtimeve të reja në infrastrukturën publike të qytetit.
4. Merr pjesë në çdo takim që organizon Drejtoria, për realizimin e objektivave të punës së drejtorive, por edhe për objektivat e drejtorive të tjera me qëllim kordinimin e punëve midis tyre.
5. Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara nga Drejtoria, duke sqaruar dhe dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit.
6. Përpilon analizën e çmimeve të preventivave të objekteve të projektuara.
7. Merr pjesë në të gjitha trajnimet dhe takimet me qëllim ngritje të kapaciteteve në fushën e projekteve.
8. Kryen detyra të tjera që i caktohen nga drejtoria brenda akteve ligjore në fuqi.
9. Manaxhon hartimin e politikave dhe kordinimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë.
10. Merr masa për harmonizimin e planeve dhe strategjive të zhvillimit të Bashkisë, me Planet kombëtare dhe Rajonale të zhvillimit.
11. Ndjek me përparësi zbatimin e programeve sociale të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe në mënyrë të vecantë, për përfshirjen e tyre në buxhet, sipas prioriteteve afatgjata;
12. Përgatit raporte, studime dhe analiza, që ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e objektivave dhe prioriteteve të planeve strategjike të zhvillimit.
13. Bashkërendon punën, ndihmon sektorë të tjerë të Bashkisë në përshtatje të punës së tyre për realizimin e objektivave dhe prioriteteve të planeve strategjike të zhvillimit;

14. Siguron kontakte të vazhdueshme në terren për një koordinim dhe menaxhim të domosdoshëm, për arritjen e rezultateve të projekteve të ndryshme.
15. Grumbullon dhe sistemon të gjithë dokumentacionin që përdoret gjatë hartimit të strategjisë dhe të programeve të zhvillimit si dhe zbatimin e tyre
16. Të bëjë përpjekje për ndryshimin dhe krijimin e mentaliteteve të reja moderne dhe të hapura në marrëdhëniet mes institucionit të Bashkisë dhe donatorëve për arritjen e rezultateve të duhura gjatë zbatimit të objektivave të kërkuara.
17. Bashkëpunon me institucionet qendrore, organizatat e huaj dhe donatorët apo OJF vendas dhe të huaj për realizimin e objektivave dhe prioriteve të planeve strategjike të zhvillimit.
18. Tërheq projektet dhe donatorë të ndryshëm në fushat prioritare të identifikuara në strategjinë e zhvillimit të qytetit.
19. Realizon informimin dhe sensibilizimin e komunitetit lidhur me projektet e përgatitura.
20. Ndjek detyrat e ngarkuara nga eprori dhe raporton për çdo problem që del gjatë punës.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotëroj Diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë dhe Inxhinieri e Burimeve Natyrore. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgoj dorazi në një zarf të mbyllur në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- a. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- b. Një kopje të jetëshkrimit.

- c. Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- d. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- e. Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- f. Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
- g. Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nëpunësit civil.
- h. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- i. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- j. Fotokopje e letërnjoftimit.
- k. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- l. Vërtetim gjendjes shëndetsore;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.06.2025.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **01.07.2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkisë Patos do të shpall në portalin Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkak të moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi legjislacionin:

- a. Ligjin nr. 152/2013, “Për nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- b. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- c. Ligjin nr. 139/2015, “Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar.
- d. Ligjin nr. 8402 dt10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
- e. Ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
- f. Ligji nr .107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, nr. 28/2017, datë 23.3.2017; nr. 42/2019, datë 4.7.2019, nr. 119/2020, datë 7.10.2020, shfuqizuar pjesërisht një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 41/2024, datë 2.5.2024.
- g. Vkm nr. 408, datë 13.05.2015 “Per miratimin e rregullores se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, i ndryshuar .
- h. Vendim nr. 283, datë 01.04.2015 “Përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”

- i. Vendimi i Këshillit Kombëtar të territorit Nr.01, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”;
- j. VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”;
- k. VKM nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.
- l. VKM nr. 9, dt. 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste"
- m. VKM nr. 425, datë 27.5.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore"
- n. VKM nr. 530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”
- o. VKM Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"
- p. VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, e ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vendin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore. Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranim në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotëroj gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën perkatese;
- e. Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- e) Të zotëroj Diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë dhe Inxhinieri e Burimeve Natyrore. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- f) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- g) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- h) Të ketë njohuri të njësive të huaja.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë diplomën bachelor, master professional ose shkencor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **08.07.2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpall në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi legjislacionin:

- a. Ligjin nr. 152/2013, “Për nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- b. Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- c. Ligjin nr. 139/2015, “Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar.
- d. Ligjin nr. 8402 dt10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”
- e. Ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
- f. Ligji nr .107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, nr. 28/2017, datë 23.3.2017; nr. 42/2019, datë 4.7.2019, nr. 119/2020, datë 7.10.2020, shfuqizuar pjesërisht një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 41/2024, datë 2.5.2024.
- g. Vkm nr. 408, datë 13.05.2015 “Per miratimin e rregullores se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, i ndryshuar .
- h. Vendim nr. 283, datë 01.04.2015 “Përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”
- i. Vendimi i Këshillit Kombëtar të territorit Nr.01, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”;
- j. VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”;
- k. VKM nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.
- l. VKM nr. 9, dt. 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste"

- m. VKM nr. 425, datë 27.5.2020 "Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore"
- n. VKM nr. 530, datë 20.7.2016 "Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve"
- o. VKM Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"
- p. VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e ndryshuar.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidateve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

2.6 DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 15/07/2025.

DREJTOR
Juela Shpata